

VENDIM
Nr.858, datë 17.12.2004

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.653, DATË 25.9.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSAT E
KONVIKTEVE, BURSAT E SHETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE DHE TË
STUDENTËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjes “c” të nenit 32 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9 165, datë 23. 12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 3 të vendimit nr.653, datë 25.9.2003 të Këshillit të Ministrave, togfjalëshi “- nuk rezultojnë kalues në të gjitha lëndët mësimore të vitit shkollor paraardhës;” zëvendësohet me “- humbasin vitin shkollor;”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano